

20260300451

Në bazë të nenit 52 paragrafi (2) të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/19), ministrja e Arsimit dhe Shkencës miratoi

PROGRAM PËR TRAJNIMET PËR AFTËSIM PROFESIONAL TË BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONALË PËR VITIN 2026

Neni 1

Me këtë program përcaktohen trajnimet për zhvillim profesional të bashkëpunëtorëve profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2026.

Neni 2

Trajnimet për zhvillim profesional të bashkëpunëtorëve profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2026 janë nga fushat, nënfushat dhe temat e mëposhtme, si vijon:

I. PËR SHKOLLAT FILLORE

1. FUSHA: Puna me nxënësit

Nënfusha: Mbështetja e nxënësve në të nxënë

Tema:

- Punë me nxënës me nevoja të ndryshme arsimore dhe zhvillimore

Nënfusha: Ndjekja dhe mbështetja e zhvillimit të nxënësve

Tema:

- Parandalimi dhe ndërhyrja në sjelljet e rrezikshme dhe problematike të nxënësit

- Përmirësimi i mirëqenies dhe zhvillimit psiko-social të nxënësve

Nënfusha: Orientimi profesional dhe i karrierës së nxënësve

Tema:

- Trajnim i avancuar për metoda, teknika dhe instrumente për këshillim dhe orientim profesional të nxënësve (program me përparësi)

2. FUSHA: Puna me mësimdhënësit

Nënfusha: Mbështetja e mësimdhënësve në punën me nxënësit

Tema:

- Mbështetje e mësimdhënësve në përgjigje të nevojave të ndryshme të nxënësve

3. FUSHA: Puna me prindërit

Nënfusha: Këshillime dhe konsultime individuale dhe në grup me prindërit

Tema:

- Këshillim individual dhe në grup i prindërve për të nxënë, sjelljen dhe zhvillimin e nxënësve

Nënfusha: Edukimi i prindërve

Tema:

- Mbështetje e prindërve për parandalimin dhe përballimin e dhunës dhe rreziqeve digjitale

4. Fusha: Bashkëpunimi me komunitetin

Nënfusha: Bashkëpunimi me institucione dhe organizata profesionale

Tema:

- Rrjetëzimi me institucione dhe organizata nga komuniteti lokal

5. FUSHA: Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional

Nënfusha: Zhvillimi profesional personal

Tema:

- Zhvillimi personal dhe profesional i bashkëpunëtorëve profesionalë

Nënfusha: Mbështetja e zhvillimit profesional dhe bashkëpunimit në shkollë

Tema:

- Zhvillimi i kompetencave profesionale dhe këshillimore dhe shkëmbimi profesional

6. FUSHA: Puna analitike-hulumtuese

Nënfusha: Hulumtimi i punës edukativo-arsimore

Tema:

- Hulumtimi aksionar si bazë për përmirësimin e praktikës edukativo-arsimore

Nënfusha: Analiza dhe vlerësimi i punës edukativo-arsimore

Tema:

- Përdorimi i mjeteve digjitale për analizë, interpretim dhe ndjekje së të dhënave

7. FUSHA: Struktura, organizimi dhe mjedisi

Nënfusha: Mjedisi i sigurt shkollor dhe pjesëmarrja demokratike

Tema:

- Zhvillimi i një mjedisi shkollor pozitive, të sigurt dhe gjithëpërfshirës

Nënfusha: Struktura dhe organizimi shkollor

Tema:

- Mbështetje në zhvillimin e politikave dhe procedurave shkollore

II. PËR SHKOLLAT E MESME

1. FUSHA: Puna me nxënësit

Nënfusha: Mbështetja e nxënësve në të nxënë

Tema:

- Parandalimi dhe ndërhyrja në sjelljet e rrezikshme dhe problematike

- Përmirësimi i mirëqenies dhe zhvillimit psiko-social të nxënësve

Nënfusha: Orientimi i karrierës së nxënësve

Tema:

- Trajnim i avancuar për metoda, teknika dhe instrumente për këshillim dhe orientim në karrierë

2. FUSHA: Puna me mësimpldhënësit

Nënfusha: Mbështetja e mësimpldhënësve në punën me nxënësit

Tema:

- Mbështetje e mësimpldhënësve në përgjigje të nevojave të ndryshme të nxënësve

- Mbështetje në krijimin e një mjedisi pozitiv socio-emocional në klasë

3. FUSHA: Puna me prindërit

Nënfusha: Këshillime dhe konsultime individuale dhe në grup me prindërit

Tema:

- Këshillim individual dhe në grup i prindërve për të nxënë, sjelljen dhe zhvillimin e karrierës së nxënësve

Nënfusha: Edukimi i prindërve

Tema:

- Mbështetje e prindërve për parandalimin dhe përballimin e dhunës dhe rreziqeve digjitale

4. FUSHA: Bashkëpunimi me komunitetin

Nënfusha: Bashkëpunimi me institucione dhe organizata profesionale

Tema:

- Rrjetëzimi me institucione dhe organizata nga komuniteti lokal

5. FUSHA: Zhvillimi profesional dhe bashkëpunimi profesional

Nënfusha: Zhvillimi profesional personal

Tema:

- Zhvillimi personal dhe profesional i bashkëpunëtorëve profesionalë

Nënfusha: Mbështetja e zhvillimit profesional në shkollë

Tema:

- Zhvillimi i kompetencave profesionale dhe këshillimore

6. FUSHA: Puna analitike-hulumtuese

Nënfusha: Hulumtimi i punës edukativo-arsimore

Tema:

- Hulumtimi aksionar si bazë për përmirësimin e praktikës edukativo-arsimore

Nënfusha: Analiza dhe vlerësimi i punës edukativo-arsimore

Tema:

- Përdorimi i mjeteve digjitale për analizë, interpretim dhe ndjekje të të dhënave

7. FUSHA: Struktura, organizimi dhe mjedisi

Nënfusha: Klima shkollore, mjedisi i sigurt dhe pjesëmarrja demokratike

Tema:

- Zhvillimi i një mjedisi shkollor pozitiv, të sigurt dhe gjithëpërfshirës

Nënfusha: Struktura dhe organizimi shkollor

Tema:

- Mbështetje në zhvillimin e politikave dhe procedurave shkollore

Neni 3

Ky program hyn në fuqi ditën pas publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Nr. 18-2540/1

11.2.2026

Shkup

Ministre

e Arsimit dhe Shkencës,

Pr. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.